

# Relacion teknik

## **Objekti: Rikonstruksion trotuari rruga Daut Boriçi**

### *Informacion i përgjithshëm:*

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi siguron respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standarteve të reja për përcaktimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmerisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

*Vendndodhja:* Lagja Nr.4, Bashkia Shkodër

*Qëllimi i projektit të propozuar:* Qëllimi kryesor i projektit është të permiresojë mjedisin urban, të krijojë hapësira miqësore për funksionimin e kësaj zone si infrastrukturë e mirëfilltë bashkëkohore dhe kthimin e saj në shërbim të komunitetit.

Ndërhyrja konsiston në rikonstruksionin e trotuarit dhe ndërtimin e rrugës së biçikletave. Ky investim synon të bëjë të mundur sigurinë e lëvizjes së këmbësorëve dhe biçiklistëve.

Projekti synon: Ndërtim me parametra europiane dhe përshtatjen e saj me rrjetin rrugor kryesor të qytetit.

Përfituesit direkt të projektit janë banorët dhe frekuentuesit e zonës.



*Të dhënat dhe gjëndja aktuale:*

Trotuari ekzistues është ndërtuar nga banorët. Në njërin anë kufizohet me mure rrethuese të banesave. Është shtruar pjesërisht dhe në mënyrë të çrregullt diku me pllaka dhe diku me beton. Gjithashtu ndryshon edhe lartësia e trotuarit, gjë që e bën pothuajse të pamundur lëvizjen e këmbësorëve në të.

Foto nga gjendja egzistuese e rrugës dhe trotuarit ku do të kryhen punimet.















## *Punimet që do të kryhen*

Sipas dokumentacionit teknik, projekt - preventivitet dhe specifikimeve përkatëse, punimet që do kryhen për këtë objekt janë:

Punime prishje ku përfshihen punimet për prishjen e trotuarit, heqjen e shtresave të asfaltit dhe transportimin e tyre për në vendin e përcaktuar nga Bashkia për hedhjen e mbeturinave.

Ndërtimi i trotuarit me shtresat përkatëse.

Ndërtimi i rrugës së biçikletave me shtresat përkatëse si dhe vendosja e xhuxhave.

Mbjellja e tre cope pemëve dekorative pas përgatitjes së tokës.

Punime sinjalistike.

Paraqitje e profilit tip te rrugës.

## PROFILI TIP

